

Ligj për themelimin e Agjencisë Nacionale për Programe Arsimore Evropiane dhe për Lëvizshmëri

TEKST I KONSOLIDUAR

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/2007, 24/2011, 24/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 53/2024 dhe 235/2024).

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet themelimi, puna, udhëheqja, drejtimi, financimi, mbikëqyrja mbi punën si edhe çështje të tjera të ndërlidhura me punën e Agjencisë Nacionale për Programe Arsimore Evropiane dhe për Lëvizshmëri.

Neni 2

Për realizimin e Programit për mësim të përjetshëm 2007-2013 dhe Programit të rinjtë në aksion 2007-2013 (në tekstin e mëtejme "Programet"), si dhe për programet që do t'i ndjekin pas përfundimit të tyre, programet dhe projektet tjera të Bashkimit Evropian, programet dhe projektet në nivel ndërkombëtar në sferën e arsimit, shkencës, hulumtimit, të rinjve, sportit dhe mobilitetit dhe programet që i jepen në kompetencë themelohet Agjencia Nacionale për Programe Arsimore Evropiane dhe për Lëvizshmëri (në tekstin e mëtejme: "Agjencia Nacionale") e cila është e pavarur në punën e vet.

Agjencia Nacionale ka cilësinë e personit juridik.

Agjencia Nacionale e fiton statusin e personit juridik me regjistrimin në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Selia e Agjencisë Nacionale është në Shkup.

Neni 3

Nacionet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

1. "Mësim i përjetshëm" është formë e mësimi të vazhdueshëm gjatë tërë jetës për shkak të përsosjes, plotësimit, thellimit dhe modernizimit të diturisë;
2. "Lëvizshmëri" është periudha kohore e kaluar në vend tjetër - pjesëmarrës në Programet e kurseve përgatitëse ose të kurseve për përsëritjen e materialeve në gjuhën e vendit ose

në gjuhën e punës, me qëllim që të realizohet studimi, të fitohet përvojë pune, aktivitete të tjera për mësim ose për ligjërime, ose aktivitete të ndërlidhur administrativ;

3. "Pjesëmarrës në tregun e punës" janë punëtorët, të vetëpunësuarit ose personat të cilët presin punësim;

4. "Bashkësia" ka të bëjë me vendet e Unionit Evropian, të vendeve kandidatë për anëtarësim, si edhe të gjitha vendet tjera të cilat pjesërisht marrin pjesë në Programet e mësimin të përjetshëm 2007-2013 dhe të rinjtë në aksion 2007-2013.

5. "Vende-pjesëmarrëse në programe" ka të bëjë me vendet e Unionit Evropian, vendet anëtare të Asociacionit Evropian për Tregti të Lirë, vendet kandidatë për anëtarësim në Unionin Evropian, dhe vende të tjera të cilat marrin pjesë në Programet.

Neni 4

Agjencia Nacionale në realizimin e Programeve:

- kontribuon në zhvillimin e bashkësisë si shoqëri e bazuar në njohuri të përparuar, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, më shumë vende pune dhe vende pune më të mira dhe kohezion social më të madh, njëkohësisht duke siguruar mbrojtje të mjedisit për gjeneratat e ardhshme, veçanërisht këmbimin, bashkëpunimin dhe lëvizshmërinë në sferën e arsimit dhe trajnimit.

- kontribuon në drejtim të zhvillimit të mësimin të përjetshëm kualitativ dhe promovon shkëlqyeshmëri, inovacion dhe dimension evropian të sistemeve dhe të praktikave nga lëmi;

- ndihmon gjatë përmirësimit të kualitetit, të aktivitetit dhe të qasshmërisë në mundësitë për mësimin e përjetshëm, të arritshëm në Vendet – pjesëmarrëse në Programet,

- e përforcon kontributin nga mësimi i përjetshëm përmes kohezionit social, qytetarëve aktivë, dialogut ndërkulturor, barazisë së gjinive dhe përmbushjes personale;

- ndihmon gjatë përparimit të kreativitetit, të konkurrencës, të punësimit dhe rritjes së frymës së sipërmarrësisë;

- kontribuon në pjesëmarrjen e zmadhuar në mësimin e përjetshëm të njerëzve nga moshat e ndryshme, duke i përfshirë edhe ato me nevoja të veçanta dhe grupet që u është bërë padrejtësi, pa dallim në pozitën e tyre sociale-ekonomike.

- e promovon mësimin e gjuhëve dhe llojllojshmërinë gjuhësore;

- e mbështet zhvillimin e përmbajtjeve inventive, të bazuara në teknologjinë informatike dhe komunikatave, të shërbimeve, të pedagogjive dhe praktikave për mësimin e përjetshëm;

- e përforcon rolin e mësimin të përjetshëm në krijimin e ndjenjës së qytetarisë evropiane të bazuar në mirëkuptim dhe në respektimin e të drejtave njerëzore dhe të demokracisë, dhe inkurajimin e tolerancës dhe të respektit ndaj popujve dhe kulturave të tjera;

- e nxit bashkëpunimin e të gjithë sektorëve të arsimit dhe të trajnimit në Evropë, më

qëllim që të sigurojë kualitet;

- e nxit përdorimin më të mirë të rezultateve, të prodhimeve inventive dhe të proceseve dhe i këmben praktikat funksionale nga sferat e përfshira me Programin e mësimin të përjetshëm, me qëllim që ta përmirësojë kualitetin e arsimit dhe trajnimit,
- shpall konkurse për shfrytëzimin e Programeve;
- i informon qytetarët për punët e ndërlidhura me Programet, përmes mjeteve të informimit publik, përpilimit të buletineve, të internet faqes ose në mënyrë tjetër; dhe
- kontribuon në arritjen e shkathtësive, kualifikimeve dhe njohurive të reja të rinjtë nëpërmjet mësimin joformal,
- bën edhe punë të tjera, të përcaktuara me ligjin.

II. PROGRAMET TË CILAT I REALIZON AGJENCIA NACIONALE

Programi për mësim të përhershëm 2007-2013

Neni 5

Programi për mësim të përhershëm 2007-2013 përbëhet nga nënprogramet Komenius, Erasmus, Leonardo Da Vinçi, Gruntving, Zhan Mone dhe Nënprogrami Transversal.

Neni 6

Nënprogrami Komenius u përgjigjet nevojave për ligjërimin dhe mësimin e të gjithë atyre nga arsimit parashkollor, themelor dhe i mesëm, dhe të institucioneve të cilat e zbatojnë arsimin e atillë, si edhe institucionet e ndërlidhura me këtë arsim;

Nënprogrami Erasmus u përgjigjet nevojave për ligjërimin dhe për mësimin e të gjithë atyre në arsimin sipëror dhe arsimin profesional dhe trajnimit në nivelin terciar, pa dallim në kohëzgjatjen e tyre ose në kualifikimin dhe i përfshin edhe studimet mjekësore dhe të institucioneve të cilat e realizojnë arsimin dhe trajnimit e atillë;

Nënprogrami Leonardo Da Vinçi, u përgjigjet nevojave për ligjërimin dhe mësimin e të gjithë atyre në arsimin dhe trajnimit profesional, në ndonjë nivel tjetër i cili nuk e përfshin atë terciar, si edhe të institucioneve dhe të enteve të cilat e realizojnë arsimin dhe trajnimit e atillë;

Nënprogrami Gruntvig u përgjigjet nevojave për ligjërimin dhe mësimin e të gjithë atyre që janë pjesë e arsimit për të moshuarit edhe të institucioneve dhe të enteve të cilat e realizojnë arsimin e atillë, dhe e përfshin;

- zhvillimin e politikave aplikative dhe të inovacioneve në mësimin e përhershëm;
- promovimin e mësimin të gjuhëve;
- zhvillimin e përmbajtjes inventive, të bazuar në teknologjinë informatike dhe

komunikatave, të shërbimeve, të pedagogjive dhe praktikave për mësimin e përhershëm; dhe

- shpërndarjen dhe aplikimin e rezultateve nga aktivitetet e mbështetura sipas programit dhe këmbimit të praktikës së mirë.

Nënprogrami Zhan Mone, përfshin shpërndarje të grandëve për mbështetjen e institucioneve dhe enteve të caktuara, të cilat zgjidhin çështje të ndërlidhura me integrimin evropian dhe shpërndarjen e grandëve për mbështetjen e institucioneve dhe asociacioneve të tjera evropiane nga sfera e arsimit dhe trajnimit.

Nënprogrami transversal e përfshin lëvizshmërinë individuale, vizitat studiuuese për ekspertët, projektet multilaterale, rrjetet tematike për punën në çështjet e ndërlidhura me përmbajtjen e mësimin të përhershëm.

Programi të rinjtë në aksion 2007-2013

Neni 7

Programi të rinjtë në aksion 2007-2013, e përfshin aktivitetin me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve.

Neni 8

Me Programin të rinjtë në aksion 2007-2013, sigurohet:

- promovimi i qytetarisë aktive të njerëzve të rinj në përgjithësi dhe veçanërisht pjesëmarrja e tyre në shoqërinë civile evropiane;
- zhvillimi i solidaritetit dhe promovimi i tolerancës të njerëzve të rinj, veçanërisht për shkak të përforcimit të kohezionit social;-
- përmirësimi i mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet njerëzve të rinj nga vendet e ndryshme;
- kontributi në drejtim të zhvillimit të kualitetit të sistemeve për mbështetjen e aktiviteteve rinore dhe aftësive të organizatave nga shoqëria civile të rinia;
- promovimi i bashkëpunimit evropian ndërmjet të rinjve.

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni i përmbush në plotësim qëllimet që realizohen në sferat tjera të aktiviteteve të bashkësisë, veçanërisht në sferën e mësimin të përhershëm, duke e përfshirë arsimin profesional dhe arsimin joformal, si edhe sfera të tjera si që janë kultura, sporti dhe punësimi.

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni, kontribuon edhe në drejtim të zhvillimit të politikave të Unionit Evropian, veçanërisht në sferën e llojllojshmërisë kulturore, multikulturore dhe linguistike në Evropë, përparimin e kohezionit social dhe luftën kundër të gjitha llojeve të

diskriminimit që bazohen mbi përkatësinë gjinore ose racore, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, invaliditetit, moshës ose orientimit seksual, gjendjes pronësore dhe pozitës shoqërore, si edhe në aspekt të zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 9

Shfrytëzuesit e Programit mund të jenë:

- nxënës, studentë, pjesëmarrës në trajnim dhe pjesëmarrës në arsimimin për të moshuarit;
- arsimtarë, profesorë, trajnues dhe personel tjetër i cili është i kyçur në cilëndo pjesë të procesit arsimor;
- pjesëmarrës në tregun e punës;
- institucione ose ente të cilat e realizojnë mësimin në suazat e Programit për mësim të përjetshëm, ose në suazat e nënprogrameve të saj;
- persona dhe organe përgjegjëse për sistemet dhe politikat të cilat kanë të bëjnë me cilëndo aspekt të mësimin të përjetshëm në nivelin lokal dhe qendror;
- ndërmarrje dhe persona të tjerë juridik, duke i përfshirë edhe shoqëritë tregtare, odat ekonomike dhe shoqatat tjera të personave juridik nga sfera e industrisë;
- institucione të cilat sigurojnë orientim, këshillim dhe shërbime informative të cilat kanë të bëjnë me cilëndo aspekt të mësimin të përjetshëm;
- asociacione të cilat veprojnë në sferën e mësimin të përjetshëm, duke i përfshirë edhe asociacionet e studentëve, asociacionet e pjesëmarrësve në trajnimin, asociacionet e nxënësve, arsimtarëve, prindërve dhe të nxënësve të moshuar;
- qendra kërkimore dhe organe të cilat i zgjidhin çështjet e ndërlidhura me mësimin e përjetshëm;
- shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet.

Neni 10

Qasjen, qëllimet dhe aktivitetet e programeve i përcakton drejtori i Agjencisë nacionale sipas rregullave të Komisionit Evropian.

Neni 11

Agjencia Nacionale i shpall konkurset nga neni 4, alineja 12 e këtij ligji, në mjetet e informimit publik dhe në internet faqen, në të cilat i thekson edhe kushtet të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët.

III. ADMINISTRIMI DHE UDHËHEQJA E AGJENCISË NACIONALE

Organi i administrimit

Neni 12

Organi i administrimit të Agjencisë nacionale është Këshilli drejtues.

Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit drejtues i emëron dhe i shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshillin drejtues e përbëjnë kryetari dhe katër anëtarë si vijojnë: nga dy prej Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave dhe një anëtar nga Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e Rinisë.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit drejtues emërohen me mandat prej gjashtë muajsh dhe mundet vetëm edhe një herë të riemërohen.

Gjatë emërimit të Këshillit drejtues mbahet llogari për përfaqësimin e drejtë dhe përkatës të të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke mos çrregulluar parimin e profesionalitetit dhe të kompetencës.

Neni 13

Kryetar dhe anëtar i Këshillit drejtues, mund të jetë personi i emëruar i cili i përmbush kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të ketë kryer arsim sipëror; dhe
- ta njohë gjuhën angleze.

Kryetari i Këshillit drejtues duhet të ketë njohuri të programeve me të cilat menaxhon Agjencia Nacionale.

Neni 14

Kryetar dhe anëtar i Këshillit drejtues, mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit, nëse:

- vetë e kërkon atë;
- e zgjedh ose e shkarkon drejtorin në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
- paraqitet si shfrytëzuesi i programeve;
- nuk i kryen detyrat e përcaktuara me ligj dhe statut.

Neni 15

Këshilli drejtues:

- e nxjerr Statutin e Agjencisë nacionale;
- e zgjedh dhe e shkarkon drejtorin;

- e miraton programin vjetor për punën e Agjencisë nacionale;
- e miraton llogarinë përfundimtare;
- e miraton raportin vjetor për punën e Agjencisë nacionale;
- e miraton raportin financiar vjetor për punën e Agjencisë nacionale;
- jep pëlqim për aktet për organizimin dhe për punën dhe për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë nacionale;
- vendos për kundërshtimet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së të punësuarve në Agjencinë nacionale;
- nxjerr rregullore për punën e vet, dhe
- bën punë të tjera të përcaktuara me Statutin.

Organi i udhëheqjes

Neni 16

Drejtori është organi udhëheqës i Agjencisë nacionale.

Drejtorin e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli drejtues.

Për zgjedhje të drejtorit publikohet shpallje publike në tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Drejtori zgjidhet për pesë vjet dhe mund të rizgjidhet vetëm edhe një mandat.

Drejtor i Agjencisë nacionale mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion i kundërvajtjes ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- 3) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka përfunduar VII/1 shkallë të arsimit dhe
- 4) ka minimum pesë vite përvojë pune;
- 5) posedon njërën nga certifikatat apo dëshmitë vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
 - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).

Neni 17

Drejtori mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur në qoftë se:

- vetë e kërkon atë;
- gjatë kryerjes së revizionit, konstatohen parregullsi serioze në punën e tij materiale-financiare, për shkak të së cilës është shkaktuar dëm i Agjencisë nacionale;
- paraqitet si shfrytëzuesi i programeve.

Neni 18

Nëse në konkursin e shpallur, nuk paraqiten kandidatë ose nëse Këshilli drejtues nuk emëron drejtor nga kandidatët e paraqitur, shpallet konkurs publik i ri.

Nëse për shkak të arsyeve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk zgjidhet drejtori ose i ka pushuar mandati para kohe, Këshilli drejtues, pa konkurs publik do të emërojë ushtrues detyre, sipas rregullit, nga radhët e të punësuarve në Agjencinë nacionale.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit, i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet të drejtorit të Agjencisë nacionale.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit, emërohet për periudhën deri në zgjedhjen e drejtorit, e më së gjati për gjashtë muaj.

Ushtrues i detyrës së drejtorit mund të emërohet personi i cili i përmbush kushtet si për zgjedhjen e drejtorit.

Neni 19

Drejtori i Agjencisë nacionale i kryen punët në vijim:

- udhëheq me punën e Agjencisë nacionale;
- e prezanton dhe e përfaqëson Agjencinë nacionale;
- e propozon programin vjetor për punën e Agjencisë nacionale, Statutin dhe llogarinë përfundimtare;
- e propozon raportin vjetor për punën e Agjencisë nacionale deri më 31 mars;
- e propozon raportin financiar vjetor të Agjencisë nacionale;
- e organizon realizimin e programit vjetor;
- i nxjerr aktet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës me të punësuarit;
- formon organe këshillëdhënës, në përputhje me Statutin;
- e bën zgjedhjen e konsumatorëve të fundit të programeve, sipas rregullave të komisionit evropian;
- përgjigjet për punën materiale-financiare dhe për ligjshmërinë e punëve në kompetencë

të tij;

- bën edhe punë të tjera, të përcaktuara me ligjin dhe me Statutin.

Neni 20

Drejtori i Agjencisë nacionale formon organe këshillëdhënës dhe angazhon bashkëpunëtorë të jashtëm, me anë të konkursit publik.

Anëtarët e organeve këshillëdhënës dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, i propozojnë konsumatorët e fundit të Programeve dhe kryejnë punë të tjera të përcaktuara me Statutin.

Anëtarët e organeve këshillëdhënës dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, i zgjedh drejtori nga radhët e kandidatëve të cilët i kanë përmbushur kushtet e përcaktuara në konkursin publik, të cilat përkojnë me obligimet dhe me aktivitetet që dalin nga programet.

Neni 21

Drejtori, kryetari dhe anëtari i Këshillit drejtues, i punësuar në Agjencinë nacionale, nuk mund të jenë shfrytëzues të Programeve.

Anëtari i organit këshillëdhënës dhe bashkëpunëtori i jashtëm, nuk mund të jenë shfrytëzues të programit për të cilin janë zgjedhur.

Neni 21-a

Të punësuarit në Agjencinë nacionale janë nëpunës shtetërorë, përveç të punësuarve që kryejnë punë ndihmëse dhe teknike.

Për të punësuarit në Agjencinë nacionale që kryejnë punë ndihmëse dhe teknike lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës, zbatohen dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune, dispozitat nga sfera e sigurimit shëndetësor, pensional dhe invalidor dhe marrëveshja kolektive.

IV. FINANCIMI I AGJENCISË NACIONALE

Neni 22

Mjetet për financimin e Agjencisë nacionale, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga Komisioni Evropian, në përputhje me Memorandumin për mirëkuptim, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Komisionit Evropian, dhe nga burime të tjera në përputhje me ligjin.

Neni 23

Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, sigurohen mjetet për rrogat dhe kompensimet, mirëmbajtja rrjedhëse dhe pajisja për punën e Agjencisë nacionale.

Bashkëfinancimi nga Komisioni Evropian do të rregullohet me marrëveshje të veçanta të lidhura ndërmjet Agjencisë nacionale dhe Komisionit Evropian.

Për financimin e programit vjetor për punën e Agjencisë për Realizimin e Programeve, Agjencia Nacionale lidh marrëveshje me Komisionin Evropian dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, që paraqet autoritet nacional për Agjencinë Nacionale.

Për financimin e Programeve hapen llogari të veçanta për çdonjërën nga programet, në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe një llogari buxhetore.

Agjencia Nacionale për kryerjen e aktiviteteve të veta të cilat dalin nga programet dhe nënprogramet, sipas nevojës hap edhe nënllogari të llogarive të veçanta të Agjencisë nacionale.

V. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 24

Gjobë në shumë prej 400 deri në 500 euro do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të Agjencisë Nacionale nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 200 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje punëtorëve në agjencinë nacionale, kryetari dhe anëtari i këshillit drejtues, anëtarët e trupave këshilldhënëse dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të angazhuar nga drejtori, nëse veprojnë në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 të këtij ligji

Neni 24-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 24 nga ky ligj, inspektori shtetërorë arsimorë është i detyruar kryerësit të kundërvajtjes t'i jep urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, të njëjtën duhet ta nënshkruaj. Pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes shënohen në procesverbal.

Në procesverbalin nga paragrafi 2 i këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të hiqen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e bërë.

Kur si kryerës të kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën kundërvajtëse e nënshkruan personi përgjegjës në personin juridik apo personin e autorizuar nga ai.

Inspektori shtetërorë arsimorë është i detyruar të mbajë evidencë për urdhërpagesat kundërvajtëse të lëshuara dhe për rezultatit e procedurës së ngritur.

Në evidencën nga paragrafi 5 i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 6 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.

Neni 24-b

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

VI. MBIKËQYRJA

Neni 25

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe mbi punën e Agjencisë nacionale, bën Ministria e Arsimit dhe Shkencës edhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Mbikëqyrje mbi punën financiare të Agjencisë nacionale, për mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, bën Ministria e Financave dhe Enti Shtetëror i Revizionit.

Me kërkesë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, revizion mund të bëjë edhe shoqëria e revizionit, të cilën e zgjedh Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nën kushte dhe në mënyrën e përcaktuar me Ligjin për furnizime publike.

Raportin nga revizioni shoqëria e revizionit ia dërgon Agjencisë nacionale dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Mbikëqyrje të drejtpërdrejtë mbi realizimin e Programeve, bën Komisioni Evropian në mënyrën e përcaktuar në Memorandumin nga neni 22 i këtij ligji.

Neni 26

Mbikëqyrje mbi realizimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve dhe të shfrytëzimit qëllimor të mjeteve, nga ana e konsumatorëve të fundit të Programeve, bën Agjencia Nacionale.

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Punët profesionale dhe administrative, që kanë të bëjnë me përgatitjen për fillimin me punë të Agjencisë nacionale, i bën Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit drejtues do të emërohen nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Këshilli drejtues, në afat prej 15 ditësh nga dita e emërimit, shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë nacionale, ndërsa drejtorin e zgjedh në afat prej 15 ditësh nga dita e skadimit të afatit në konkursin publik.

Agjencia Nacionale fillon me punë me ditën e zgjedhjes së drejtorit.

Këshilli drejtues e miraton Statutin në afat prej 60 ditësh nga dita e emërimit të kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit drejtues.

Aktet për organizimin dhe punën dhe për sistematizimin e vendeve të punës, drejtori i Agjencisë nacionale do t'i nxjerrë në afat prej 60 ditësh nga dita e zgjedhjes së tij.

Mjetet për punën e Agjencisë nacionale, të përcaktuara me nenin 22 të këtij ligji, deri në fillimin me punë të Agjencisë nacionale, do të sigurohen në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

DISPOZITA NGA LIGJET PËR NDRYSHIM DHE/OSE PLOTËSIM

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2011):

Neni 6

Akti i organizimit të brendshëm dhe akti i sistematizimit të vendeve të punës në Agjencinë nacionale, të harmonizohen me këtë ligj në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

Neni 2

Drejtori i Agjencisë nacionale i zgjedhur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është zgjedhur.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

Neni 4

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji që kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj do të fillojnë të zbatohen pas dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për Lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

Neni 4

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/2016):

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

Neni 2

Dispozitat e nenit 16 paragrafi (5) pika 5) të Ligjit për themelimin të Agjencisë nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 113/2007, 24/11, 24/13, 41/14, 145/15 dhe 55/16) dhe dispozitat të nenit 1 të këtij ligji me të cilin neni 16 paragrafi (4) pika 5) plotësohet me aline të re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

Neni 3

Drejtori i cili është i zgjedhur nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, është i obliguar ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij.

Drejtorit i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afatin të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i pushon mandati.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për programe arsimore evropiane dhe për lëvizshmëri ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/2024):

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".